



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GJERGJ R. KONGOLI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA
NR. 3
TEL: 0682033057

KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2585

Nr. koleksioni: 682

Tirane më 24/06/2020



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020053630031516544



**KONTRATË SHITBLERJE ME REZERVË
KUOTASH KAPITALI
(TË SHOQËRISË "DITË E NATË" SH.P.K)**

Sot, më datë 24.06.2020, para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINSITRATIVE NR. 10, RR. KONT URANI, GODINA NR. 3, paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I. PALËT

Pala Shitëse: 1) **znj. Klodiana Stopani**, e bija e *Fani-t*, lindur me *04.08.1981* në *Patos* dhe banuese në Tirane, rruga Tom Plezha, Pallati Konfort Konstruksion Ap. 40, Shk. 2, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me numer 034279172 dhe numër personal *I15804002K*.

2) **z. Redi Goga**, i biri i *Fanit*, lindur më *27.12.1988*, në *Fier* dhe banues në Tiranë, rruga *Aleksandri i Madh, pll.2, Art, Shk. 2/8, p. 38, Tirane*, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. *031528207* dhe numër personal *I81227074K*

Dhënës Pëlqimi: **Vasillaq Stopani**, shtetas shqiptar, lindur me *30.12.1969*, në *Sqepur, Berat* dhe banues në Tiranë Tirane, rruga Tom Plezha, Pallati Konfort Konstruksion Ap. 40, Shk. 2, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. *034279171* dhe nr. personal *G91230001U*, në cilësinë e bashkëshortit se znj. Klodiana STOPANI

Pala Blerëse: **Shoqëria "METRO FARMACI" SHPK**, shoqëri tregtare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë *03.02.2015*, me NUIS (NIPT) *L52403033A*, me zyrë qendrore në Tirane, rruga "Myslym Shyri", pallati 10, kati përdhe, dyqani nr.1, e përfaqësuar nga ortaku i vetëm z. **Dorian Sadiku**, i biri i Tahirrit, lindur më *20.06.1979*, në Shkodër dhe banues në Tiranë, Bulevardi "Gjergj Fishta", pallati Selmani, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. *028835695* dhe numër personal *H90620115D*.

Kushtet Paraprake

- Shoqëria "DITË E NATË" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si

Fq. 1



person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 17.02.2020, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) M01417001E; me zyrë qendrore në Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 2, rruga "Luigj Gurakuqi", pallati Nr. ¼,; me kapital të regjistruar 100,000 (njëqind mijë) lekë; me dy ortakë, znj. Klodiana Stopani, zotëruese e 1 (një) kuote, e cila përbën 66% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe z. Redi Goga, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 34 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;

- Shoqëria "DITË E NATË" SHPK ka një rrjet aktiv farmacish, të shpërndara në qytetin e Tiranës, Lezhë e Shkodër etj, për të cilat kjo shoqëri nëpërmjet financimit të dy ortakëve të saj, znj. Klodiana Stopani dhe z. Redi Goga ka kryer investime të cilat janë pjesë e aseteve dhe/ose kapitalit të shoqërisë.
- Shoqëria "DITË E NATË" SHPK, ka të regjistruar në pronësinë e saj, në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave, një Markë Individuale, lloji i markës "Fjalë e Figurë"; me ngjyrë Blu, e bardhë, e gjelbër; emri i markës "DITË E NATË FARMACI".

Pala shitëse është e interesuar të shesë pjesën e kuotës e cila përfaqëson 90% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë pjesë të kuotës;

Palët paraprakisht kanë rënë dakord që çmimi i kësaj kontrate do të paguhet nga pala blerëse me këste;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Redi Goga, i shet palës blerëse shoqëria "METRO FARMACI" SHPK, kuotën që ai zotëron në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK dhe e cila përbën 34% të kapitalit të kësaj shoqërie.

2.2 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse znj. Klodiana Stopani, i shet palës blerëse shoqëria "METRO FARMACI" SHPK, pjesën e kuotës që ajo zotëron në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK dhe e cila përbën 56% të kapitalit të kësaj shoqërie.

2.3 Palët bien dakord që kjo kontratë është një kontratë shitje me rezervë, pasi çmimi i kësaj kontrate prej palës blerëse me këste

2.4 Pas regjistrimit të kësaj kontrate, ortakët e shoqërisë "DITË E NATË" SHPK, do të jenë:

- shoqëria "METRO FARMACI" SHPK, e cila do të jetë zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 90% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK;
- znj. Klodiana Stopani, e cila do të jetë zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotave që përfaqësojnë 90% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK është 700.000 (shtatëqind mijë) Euro.

3.2 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës që z. Redi Goga zotëron në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, e cila përfaqëson 34% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, është 238.000 (dyqind e tridhjetë e tetë mijë) Euro.

3.3 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së pjesës së kuotës që znj. Klodiana Stopani zotëron në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, e cila përfaqëson 66 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, është 462.000 (katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) Euro

3.4 Palët bien dakord që çmimi i shitjes prej 700.000 (shtatëqind mijë) Euro do të paguhet, si më poshtë:

a) kësti i parë në vlerën 50.000 mijë (pesëdhjetë mijë euro), do të paguhet nga pala blerëse menjëherë me nënshkrimin e kontratës në llogarinë bankare ndërmjetëse OSS të Noterit Gjergj Kongoli pranë Bankës Raiffeisen Sh.A me nr.0030734743, dhe më pas nga noteri 17.000 mijë (shtatëmbëdhjetë mijë) euro do të





transferohen në llogarinë bankare të palës shitëse Z. Redi Goga dhe 33.000 (tridhjetë e tre mijë Euro) do të transferohen në llogarinë bankare të palës shitëse Znj. Klodiana Stopani.

b) Vlera e mbetur prej 650.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) Euro do të paguhet sipas mundësive paguese të palës blerëse por me kushtin që e gjithë vlera e mbetur të likujdohet brenda vitit 2020. Pagesa e kësaj shume, do të paguhet nga pala blerëse shoqëria "METRO FARMACI" SHPK në llogarinë bankare ndërmjetëse OSS të Noterit Gjergj Kongoli pranë Bankës Raiffeisen Sh.A me nr.0030734743, për tu transferuar më pas nga noteri, në llogaritë bankare të palës shitëse sipas përqindjes së kapitalit themeltar që përfaqëson kuota që zotëron dhe po shet secili prej ortakëve.

3.5 Për çdo vonesë në pagesën e vlerës së kësaj kontrate, do të aplikohet një interes në masën 6% në vit, i llogaritur mbi vlerën e papaguar.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj kanë të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar dhe teknik të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 e 3.2 të kësaj kontrate.

4.3 Palët e kësaj kontrate detyrohen që asnjëra prej tyre të mos tërhiqet nga kjo kontratë. Në rast se ndonjëra prej palëve tërhiqet nga kontrata apo kryen ndonjë veprim me qëllim mosplotësimin e kushteve të përcaktuara në dispozitat e kësaj kontrate, atëherë pala që tërhiqet ose kryen veprimin, detyrohet t'i paguajë palës tjetër dëmin e shkaktuar. Palët bien dakord që vlera e dëmit është e barabartë me dyfishin e vlerës së kuotës dhe dyfishin e vlerës së pjesës së investimit të kryer deri në atë moment nga pala e dëmtuar.

V. KALIMLI PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, pavarësisht se është një kontratë shitje me rezervë do të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe shoqëria "METRO FARMACI" SHPK do të bëhet ortakë në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK, duke zotëruar 90% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Në momentin e regjistrimit të kësaj kontrate sipas nenin 5.1, pronësia mbi kuotën e cila përbën 90% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "DITË E NATË" SHPK, do të kalojë nga pala shitëse Redi Goga e Klodiana Stopani, tek pala blerëse shoqëria "METRO FARMACI" SHPK.

5.3 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e pjesën e kuotës e cila përfaqëson 90% të kapitalit të shoqërinë "DITË E NATË" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse, shoqëria "METRO FARMACI" SHPK.

VI. DHËNËSI I PËLQIMIT

Dhënësi i pëlqimit z. Vasillaq Stopani, bashkëshorti i ortakes Klodiana Stopani dhe bashkëpronar në kuotën që znj. Klodiana Stopani zotëron në shoqërinë "DITË E NATË" SHPK. për efekt të martesës, deklaron se është dakord që pjesa e kuotës, objekt i kësaj kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortes së tij, t'i shitet shoqërisë "METRO FARMACI" SHPK.

Dhënësi i pëlqimit z. Vasillaq Stopani, deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të bashkëshortes së tij për shitjen e pjesës së kuotës dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me shitje apo me çdo vendimmarrje tjetër që znj. Klodiana Stopani po ndërmerr e do ndërmarrë, në marrdhënien tregtare me shoqërinë "METRO FARMACI" SHPK.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale,



një original regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një original e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje me ligjin dhe vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë me zë të lartë.



PALA BLERËSE

SHOQËRIA "METRO FARMACI" SHPK

Klodiana Stopani
[Signature]

përfaqësuar nga ortaku i vetëm
DORIAN SADIKU

Dorian Sadiku
[Signature]



REDI GOGA

Redi Goga
[Signature]

**DHËNËSI I PËLQIMIT
VASILLAQ STOPANI**

Vasillaq Stopani
[Signature]

**NOTER
GJERGJ KONGOLI**

[Signature]

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20200624131427164
Data e Rezultatit te Kerkimit: 24.06.2020
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 1:14:27PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-585-3095
Referenca e Perdoriesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

DITE E NATE SH.P.K.



Aranda Lekku



Njoftim Debitimi / Debit Advice



Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX

Dega / Branch 001

Data / Date 26/06/2020

Midas Reference / Midas Reference Number P200626AA8UOP14

Luka Reference / Luka Reference Number 20200626OLTA.HOXHA00133224

Klienti Urdherues / Ordering Customer METRO FARMACI SHPK L52403033A
L.K.PARISIT. RR.D.B.MITROVICA DQ.1

Numri i llogarise / Account Number 0011334304

IBAN AL10202110130000000011334304

Shuma e urdheruar 50,000.00

Monedha EUR

Kursi i kembimit 1.00000000

Detajet e pageses / Details of Payment KEST BLERJE KUOTAVE

Komisione / Commissions 1.20

Klienti Perfitues / Beneficiary Customer GJERGJ KONGOLI PF L31412012T

Numri i llogarise 0030734743

IBAN AL71202110680000000030734743

Date Valuta / Value Date 26/06/2020

Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.

